




Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse / Privremena Institucija Samouprave / Provisional Institutions of Self Government  
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo  
Ministria e Shërbimeve Publike / Ministarstvo javnih službi / Ministry of Public Services

## **Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Ambientit**

# **Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2004**



**Enti i Statistikës së Kosovës  
Zavod za Statistiku Kosova  
Statistical Office of Kosovo**

## Parathënie

Është hera e katërt që Enti i Statistikës së Kosovës, konkretisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Ambientit kryen anketën e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore.

Qëllimi i kësaj ankete është që të sigurohen të dhëna statistikore të qëndrueshme për sektorin e bujqësisë në Kosovë.

Rezultatet e Anketës së Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2004, siç janë të prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm të informatave mbi gjendjen e tanishme të bujqësisë në Kosovë.

Përmirësime të mëtutjeshme në qëndrueshmërinë e të dhënave mund të priten atëherë kur në Kosovë të kryhen Regjistrimi i Bujqësisë dhe Regjistri i Fermave.

Ky publikim është rezultat i bashkëpunimit të Entit të Statistikës së Kosovës (ESK) dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), përmes grupeve të përbashkëta punuese.

I gjithë ky aktivitet është mbështetur nga Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER), përmes projektit të financuar "Shërbimet komplementare për Statistika Bujqësore dhe Njësia Këshilluese e Politikës në Kosovë (ASPAUK II)", të implementuar nga NR Internacional/ ADAS.

Ky Publikim është i pregaditur nga ana e Departamentit të Statistikave të Bujqësisë dhe Ambientit në ESK, stafi i të cilit Departament përbëhet nga: Bajrush Qevani, Haki Kurti, Rexhep Fejzullahu, Habib Strana, Güven Güneren (UNMIK) në bashkëpunim të ngushtë me konsulentët e projektit ASPUK II: Avni Ramadani, Lulzim Shala, Muhedin Nushi, Valerie Evans, Emma Chapman dhe Dr. Sophia Davidova.

ESK gjithashtu dëshiron ti falënderoj të gjithë punëtorët e zyrave regjionale të ESK-s, anketuesit dhe respondentët në teren për bashkëpunim dhe kontributin e dhënë.

Ne do ti mirëpresim komentet dhe sugjerimet të cilat ju mund ti keni lidhur me këtë publikim në mënyrë që publikimet tjera në të ardhmen ti plotësojnë më mirë nevojat e shfrytëzuesve.

Kryeshefi Ekzekutiv i ESK  
Hysni Thaçi

Prishtinë, Nëntor 2005

## Shkurtesat dhe akronimet

AER	Agjencioni Evropian për Rindërtim
AESHB	Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
ASPAUK II	Shërbimet plotësuese për Statistika Bujqësore dhe Njësia Këshilluese e Politikës në Kosovë (ASPAUK II)
BE	Bashkimi Evropian
ESH	Ekonomi Shtëpiake
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
FADN	Rrjeti i të Dhënave për Kontabilitetin e Fermave
LSMS	Anketa për Matjen e Standardit Jetësor
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
NPSH	Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore
NVP	Njësia Vjetore Punuese
PPS	Probabiliteti proporcional sipas madhësisë
PSU	Njësia Primare Mostrore
UNMIK	Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara, Misioni në Kosovë

## Çelësi i simboleve

-	Amplituda zero
:	Të dhënat që mungojnë
.	Të pa aplikueshme
0	Amplituda më pak se gjysmë njësie e angazhuar
0, 0	Amplituda më pak se gjysmë njësie e angazhuar
ha	Hektarë
kg	Kilogram
t	Ton
kf	Kalë fuqi
%	Përqindje

Në tabelat ku janë rrumbullakuar shifrat deri në shifrën e fundit më të afërt, mund të ketë mospërputhje të lehtë të shumave të artikujve përbërës të prezantuar.

## Përmbajtja

1	Objektivat, metodologjia dhe shtrirja e anketës.....	5
1.1.	Objektivat dhe shtrirja e anketës.....	5
1.2.	Korniza e anketës.....	5
1.3.	Dizajni i mostrës.....	6
1.4.	Procedura e vlerësimit.....	7
1.5.	Definicionet.....	7
1.6.	Procedura në teren.....	8
2	Ekonomitë shtëpiake.....	8
3	Shfrytëzimi i tokës dhe struktura e fermës.....	14
4	Kulturat bujqësore.....	19
5	Pylltaria.....	21
6	Blegtoria.....	24
7	Inputet bujqësore.....	26
8	Fuqia punëtore në bujqësi.....	29
9	Shpenzimet e fermës.....	31
	Table 1: Kufiri për ferma të mëdha dhe të specializuara sipas tipit të fermës.....	7
	Table 2: Popullsia bujqësore sipas grup moshave.....	9
	Table 3: Popullsia bujqësore sipas grupmoshave në komuna.....	11
	Table 4: Popullsia bujqësore sipas gjinisë në komuna.....	12
	Table 5: Shkollimi i popullsisë bujqësore sipas moshës (nga 15-64 vjeç).....	13
	Table 6: Shkollimi i popullsisë bujqësore sipas gjinisë (nga 15-64 vjeç).....	13
	Table 7: Shfrytëzimi i tokës.....	14
	Table 8: Ujitja e tokës së kultivuar sipas komunave.....	16
	Table 9: Toka bujqësore sipas madhësisë së fermës dhe strukturës së fermës.....	17
	Table 10: Sipërfaqja e përgjithshme e tokës sipas shfrytëzueshmërisë dhe strukturës së fermës.....	18
	Table 11: Toka bujqësore sipas statusit pronësor dhe strukturës së fermës.....	18
	Table 12: Sipërfaqja me kultura, prodhimtaria dhe rendimenti.....	20
	Table 13: Numri i ekonomive shtëpiake që posedojnë pyje sipas komunave.....	21
	Table 14: Sasia dhe qëllimi i shfrytëzimit të drurit sipas komunave.....	22
	Table 15: Llojet e drurit.....	23
	Table 16: Prezantimi numerik i blegtorisë në Nëntor – Dhjetor 2004.....	24
	Table 17: Makineria dhe pajisjet në ekonomitë shtëpiake bujqësore.....	26
	Table 18: Përdorimi i plehrave minerale dhe organike sipas ekonomive shtëpiake.....	27
	Table 19: Përdorimi i plehrave minerale dhe organike sipas kulturave.....	27
	Table 20: Anëtarët e ekonomive shtëpiake të angazhuar në fermë.....	29
	Table 21: Fuqia punëtore me medijtje e angazhuar në bujqësi, ditët e punës.....	30
	Table 22: Struktura e shpenzimeve në fermë.....	31
	Table 23: Llojet e shpenzimeve të fermës sipas komunave.....	32
	Figure 1: Madhësia e ekonomisë shtëpiake bujqësore.....	9
	Figure 2: Shfrytëzimi i tokës bujqësore.....	15
	Figure 3: Arsyet e dhëna nga fermerët për tokën e lënë djerrinë.....	15
	Figure 4: Sipërfaqja me kultura sipas kategorive.....	19
	Figure 5: Shfrytëzimi i pyjeve.....	23
	Figure 6: Llojet e drurit.....	24

# 1 Objektivat, metodologjia dhe shtrirja e anketës

## 1.1. Objektivat dhe shtrirja e anketës

Objektiv i Anketës së Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2004 ishte të sigurojë të dhëna mbi gjendjen e bujqësisë në Kosovë, në lidhje me demografinë e ekonomive shtëpiake bujqësore; shfrytëzimin e tokës dhe strukturën e fermës; blegtorinë; kulturat bujqësore; pylltarinë; inputet bujqësore; makinerinë dhe fuqinë punëtore. Anketa ka për qëllim të ndihmojë në vlerësimin e gjendjes së bujqësisë në Kosovë dhe të sigurojë bazën e monitorimit të ardhshëm të trendeve në këtë sektor.

Anketa përfshin tokën e punuar nga ekonomitë shtëpiake bujqësore që jetojnë dhe punojnë në zonat rurale<sup>1</sup>. Këtu nuk përfshihet toka e poseduar nga ekonomitë shtëpiake bujqësore që jetojnë në fshat por të cilat nuk e kultivojnë tokën, ata që jetojnë në zonat urbane në Kosovë ose jashtë vendit; përveç nëse kjo tokë është marrë me qira nga ekonomitë shtëpiake bujqësore në zonat rurale. Kjo është ndryshe nga anketat e viteve të mëparshme kur është përfshirë edhe toka në pronësi private e të gjitha ekonomive shtëpiake bujqësore, pa marrë parasysh nëse kanë jetuar në Kosovë ose jashtë vendit.

Në vazhdim toka e poseduar nga ekonomitë shtetërore – e papunuar nga ekonomitë shtëpiake bujqësore – nuk është përfshirë. Të dhënat janë prezantuar në nivel kombëtar dhe në disa raste në nivel komunal.

Anketa është kryer nga muaji Nëntor i vitit 2004 deri në Janar të vitit 2005. Anketa është kryer për çdo vit që nga viti 2001. Veçori të rëndësishme të kësaj ankete në krahasim me ato të viteve të mëparshme janë: mostra më e madhe e ekonomive shtëpiake të intervistuar; fermat e mëdha janë anketuar të gjitha, dhe korniza nga e cila është zgjedhur mostra është pasuruar plotësisht me të dhëna<sup>2</sup>.

## 1.2. Korniza e anketës

Në fund të gushtit dhe në shtator të vitit 2004 të gjitha fshatrat rurale në Kosovë janë vizituar dhe në bazë të pyetësorit drejtpërdrejt me udhëheqësit e fshatrave, janë marrë vlerësimet me qëllim të pasurimit të kornizës së anketës. Për secilin fshat janë mbledhur vlerësimet për:

- Numrin e ekonomive shtëpiake në fshat;
- Numrin e ekonomive shtëpiake bujqësore në fshat;
- Numrin e banorëve në fshat;
- Numrin e familjeve nga fshati të cilat jetojnë jashtë fshatit;
- Numrin e familjeve që momentalisht jetojnë në fshat;
- Numrin e banorëve të fshatit të cilët jetojnë jashtë fshatit;
- Numrin e banorëve që të cilët momentalisht jetojnë në fshat.

Në 468 fshatra të zgjedhura sipas rastësisë, është bërë verifikimi i vlerësimeve përmes një listimi të plotë të të gjitha ekonomive shtëpiake.

bujqësore në fshat. Në shumicën e fshatrave numri i ekonomive shtëpiake bujqësore ishte më i vogël se ai i parashikuar nga udhëheqësi i fshatit. Përshtatjet në kornizë janë bërë në përputhje me rrethanat. Kjo kornizë mund të mos jetë aq e besueshme sa do të ishte regjistrimi i përgjithshëm i ekonomive shtëpiake bujqësore, pasi që bazohet në pjesën e

---

<sup>1</sup> Së paku një anëtar i ekonomisë familjare bujqësore duhet të merret me veprimtari bujqësore

<sup>2</sup> Madhësia e mostrës së vitit 2001 ishte 1,440 ekonomi shtëpiake bujqësore; në vitin 2002 ishte 3,200; në vitin 2003 ishte 1,264, dhe; në vitin 2004 ishte 4,646 ekonomi shtëpiake bujqësore.

vlerësimeve të bëra nga udhëheqësi i fshatit, kjo prezanton pasurimin e të dhënave të përdorura më herët që bazoheshin në të dhënat e vitit 1981.

Korniza e pasuruar përfshin 117.967 ekonomi shtëpiake në zonat rurale të Kosovës. Numri i ekonomive shtëpiake bujqësore i supozuar viteve të mëhershme ishte më i lartë<sup>3</sup>. Kjo duhet të merret parasysh kur të krahasojmë rezultatet e anketës së ekonomive bujqësore të vitit 2004 me vitet paraprake.

### 1.3. Dizajni i mostrës

Anketa është bazuar në mostrën e shtresuar në dy nivele. Madhësia e mostrës ishte 4646 ekonomi shtëpiake bujqësore. Niveli i parë i shtresimit ishte nga komuna për të gjetur vlerësimin e komunës dhe për të siguruar mbulimin e plotë gjeografik. Shtresimi i dytë ishte sipas madhësisë së fshatit për të siguruar përfaqësimin e ekonomive shtëpiake bujqësore që gjenden në fshatrat e madhësive të ndryshme. Në mungesë të një regjistri të fermave të Regjistrimit Bujqësor nuk ishte e mundur që të bëhet shtresimi i mostrës në bazë të tipit të ekonomisë shtëpiake apo të madhësisë.

Fshatrat në kornizë janë përdorur për të formuar Njësitë Primare Mostrore (PSU), nga e cila sipas metodës së rastit është bërë zgjedhja e ekonomive shtëpiake bujqësore për intervistë. Metoda e përdorur për të formuar PSU-të ishte:

- Për fshatrat e vogla me më pak se 50 ekonomi shtëpiake bujqësore, është bërë grupimi i disa fshatra të vogla (në bazë të afërsisë gjeografike) për të formuar një PSU nga së paku 50 ekonomi shtëpiake bujqësore;
- Për fshatrat me madhësi mesatare, i tërë fshati përbën një PSU;
- Për fshatrat e mëdha, fshati është ndarë në pjesë, që përbëjnë 150 deri 200 ekonomi shtëpiake bujqësore. Secila pjesë ka formuar një PSU.

Madhësia e komunës, sa i përket numrit të përgjithshëm të ekonomive shtëpiake bujqësore, përcaktoi numrin e Njësitë Primare Mostrore (PSU), të zgjedhura në secilën komunë.

- Për komunat me mbi 7.000 ekonomi shtëpiake bujqësore, janë zgjedhur 25 PSU, (dmth. 200 ekonomi shtëpiake bujqësore);
- Për komunat me nga 4.000 – 7.000 ekonomi shtëpiake bujqësore, janë zgjedhur 20 PSU (dmth. 160 ekonomi shtëpiake bujqësore);
- Për komunat me më pak se 4.000 ekonomi shtëpiake bujqësore, janë zgjedhur gjysma e PSU-ve të komunës.

Në secilën PSU të zgjedhur, 8 ekonomi shtëpiake bujqësore janë zgjedhur sipas rastësisë për intervistë. Kjo është bazuar në një listë të të gjitha ekonomive shtëpiake në PSU-të e zgjedhura (Shih seksionin 1.6). Për fshatrat më të mëdha, është zgjedhur më shumë se një PSU në një fshat, janë përfshirë të gjitha PSU-të e fshatit. Gjithsej 535 PSU janë përfshirë në mostër. Në disa komuna me numër relativisht të vogël të ekonomive shtëpiake bujqësore, janë përfshirë më pak se 20 PSU<sup>4</sup>. Për këto komuna vlerësimet nuk janë të besueshme në nivel komunal por do të kontribuojnë në besueshmërinë e vlerësimeve në nivel të Kosovës.

Niveli i dytë i shtresimit ishte në secilën komunë, për të shtresuar PSU-të në bazë të madhësisë së fshatit: fshat i vogël (më pak se 75 ekonomi shtëpiake bujqësore); fshat mesatar (75-150 ekonomi shtëpiake bujqësore); dhe fshat i madh (më shumë se 150 ekonomi shtëpiake bujqësore). Numri i PSU-ve të zgjedhura nga secila kategori e fshatit ka reflektuar numrin e proporcional të ekonomive shtëpiake bujqësore që jetojnë në fshatra të vogla, të mesme dhe të mëdha në secilën komunë. PSU-të nga secili shtresim i fshatit janë zgjedhur sipas probabilitetit proporcional të madhësisë (PPS) duke u bazuar në numrin e ekonomive shtëpiake bujqësore në secilën PSU.

---

<sup>3</sup> Numri i përgjithshëm i ekonomive shtëpiake bujqësore të përdorura në kornizat e viteve të mëhershme (duke u bazuar në të dhënat e vitit 1981) në vitin: 2001 ishte: 154,752; në vitin 2002: 157,600; dhe në vitin 2003: 169,473.

<sup>4</sup> Novobërda; Zveçani; Zubin Potoku; Shtërpca; Obiliqi; Fushe Kosova; Shtimja; Mitrovica; Leposaviqi; Klina; Dragashi.

Për të zvogëluar heterogjenitetin e kornizës së mostrës, dhe po ashtu për të përmirësuar vlerësimet, të gjitha njësitë që ishin mbi distribuimin normal sa përket madhësisë së fermës, janë identifikuar dhe anketuar plotësisht. Këto janë referuar si ferma të mëdha dhe të specializuara. Për të përcaktuar listën e “fermave të mëdha dhe të specializuara” të cilat janë anketuar plotësisht, përcaktimi i kufirit sipas tipit të fermës është bërë në konsultim me ekspert të MBPZHR-së, agronomëve dhe ekspertëve lokal e ndërkombëtar dhe agro-përpunuesve, si dhe analiza e të dhënave ekzistuese. Kufiri i përcaktuar gjithashtu ka marrë parasysh burimet ekzistuese për anketim të plotë të fermave të zgjedhura. Tabela 1. prezanton kufirin e përdorur për të zgjedhur fermat e mëdha dhe të specializuara.

**Table 1: Kufiri për ferma të mëdha dhe të specializuara sipas tipit të fermës**

Prodhimi	Kufiri i zgjedhur
Patate	10 ha
Drithëra	50 ha
Bimë industriale	Tërë fermat
Pemishte	1,5 ha
Vreshta	4 ha
Hortikulturë e hapur	3 ha
Hortikulturë e mbyllur	0,30 ha
Gjedhe	35
Dele	200
Dhi	40
Derra	35
Pula	4.000

Në mungesë të një regjistri të plotë të fermave, është përpiluar një listë e të gjitha fermave në Kosovë mbi madhësinë e kufirit. Kjo është kryer përmes vizitave në secilën komunë për t'u konsultuar me zyrtarët komunal duke iu referuar të dhënave ekzistuese.

Janë identifikuar 376 ferma të mëdha e të specializuara dhe janë anketuar plotësisht. Këto i referohen në këtë publikim si “ferma të mëdha”. Ato nuk janë patjetër ferma komerciale. Të gjitha ekonomitë tjera shtëpiake bujqësore i referohen kapitujve pasues si ‘ekonomi të vogla shtëpiake bujqësore apo ferma’.

#### 1.4. Procedura e vlerësimit

Peshat janë aplikuar në nivelin komunal.

#### 1.5. Definicionet

Anketa është kryer duke përdorur definicionet pasuese të rëndësishme:

“Ekonomi Shtëpiake” është një bashkësi e personave që jetojnë bashkë, grumbullojnë dhe shpenzojnë të ardhurat e tyre të përbashkëta.

“Ekonomi Shtëpiake Bujqësore” është ajo që posedon dhe kultivon më shumë se 0.10 ha tokë të punueshme<sup>5</sup>, ose më pakë se 0.10 ha tokë të punueshme por që ka së paku:

- 1 lopë dhe 1 viç, ose 1 lopë dhe 1 mëshjtjerr,
- 1 lopë dhe 2 frymë dele apo dhi,
- 5 dele apo dhi te rritura,
- 4 dele të rritura dhe derra së bashku
- 3 derra të rritur,
- 50 shpezë të rritura,

<sup>5</sup> Ara, kopshte, serra, pemishte, vreshta, livadhe

- 20 koshere bletësh,
- ose më shumë se 20 metra katror hurdh peshku.

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës së ekonomisë shtëpiake përfshin tërë tokën në pronësi të ekonomisë shtëpiake, të përdorur apo të papërdorur, dhe tokën që është marrë me qira, duke përfshirë tokën që është dhënë me qira.

## 1.6. Procedura në teren

Puna në teren është bërë në dy faza. Faza e parë ishte listimi i të gjitha ekonomive shtëpiake bujqësore në fshatrat e zgjedhura. Stafi në teren, në disa raste duke përdorur edhe harta të fshatrave, ka shkuar derë më derë dhe ka mbledhur informata duke përdorur pyetësorët. Rezultatet e kësaj pune janë përdorur për të zgjedhur ekonomitë shtëpiake bujqësore për anketim.

Faza e dytë e punës në teren ishte mbledhja e të dhënave nga ekonomitë shtëpiake bujqësore të zgjedhura. Kjo metodë e mbledhjes së të dhënave ishte intervistë e drejtpërdrejtë duke u bazuar në pyetësor (Aneksi).

Është kryer edhe procedura e kontrollimit të të dhënave. Kjo është bërë në tre nivele: (i) kontrollimi i pyetësorëve të kompletuar në teren nga ana e mbikëqyrësve në teren; (ii) kontrollimi i pyetësorëve të kompletuar në zyrën qendrore të ESK-së nga stafi i përhershëm i Departamentit të Bujqësisë, dhe (iii) kontrollimet logjike gjatë përfshirjes së të dhënave. Pas kryerjes së punës në teren është bërë edhe një kontroll i kualitetit. Janë zgjedhur gjithsej 100 ekonomi shtëpiake bujqësore (të zgjedhura sipas rastit nga PSU-ja dhe ekonomive shtëpiake bujqësore). Këto ekonomi shtëpiake janë ri-intervistuar për të verifikuar vlefshmërinë e të dhënave të mbledhura më herët. Nuk janë gjetur mospërputhje të mëdha<sup>6</sup>.

## 2 Ekonomitë shtëpiake

Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore për vitin 2004 ka mbledhur të dhëna mbi anëtarët e ekonomive shtëpiake. Duke pasur parasysh ndryshimet e shumta në Kosovë në 15 vitet e fundit, të dhënave të pamjaftueshme mbi popullsinë e tashme<sup>7</sup> gjë që krijon probleme në interpretimin e statistikave. Ky kapitull siguron të dhëna për ekonomitë shtëpiake bujqësore në vitin 2004 lidhur me moshën, gjininë dhe arsimimin e anëtarëve të ekonomive shtëpiake dhe informata lidhur me anëtarët e familjes që jetuan jashtë familjes gjatë 12 muajve të fundit.

Vlen të përmendet që janë përfshirë vetëm ekonomitë shtëpiake që jetojnë në fshat dhe që merren me bujqësi. Në këto rrethana pritet që shifrat për popullsinë bujqësore të ndryshojnë nga anketa bujqësore e vitit 2001 me ç'rast janë përfshirë edhe ekonomitë shtëpiake që jetonin në vende tjera e po ashtu edhe ata që jetonin jashtë Kosovës. Tabela 2. prezanton anëtarët e ekonomive shtëpiake në Kosovë sipas grup moshave.

---

<sup>6</sup> Disa ndryshime të vogla janë vërejtur nga përgjigjet e marra nga ekonomitë shtëpiake bujqësore. Kjo duket se është për shkak të mungesës së mbajtjes së shënimeve të dhënave me shkrim dhe parashikimeve të marra nga ekonomitë shtëpiake bujqësore në kohën e intervistimit.

<sup>7</sup> Për shkak të mungesës së regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë




**Table 2: Popullsia bujqësore sipas grup moshave**

Grup moshë	Numri	%	% kumulative
Deri në 14	278.405	30,7	30,7
15-29	267.467	29,5	60,1
30-49	218.856	24,1	84,2
50-64	89.391	9,8	94,1
Mbi 65	53.804	5,9	100,0
Gjithsej	907.925	100,0	

Kjo tabelë paraqet gjithsej rreth 908.000<sup>(8)</sup>. Mbi 60 % të popullsisë është nën 30 vjeç. Ekonomitë shtëpiake bujqësore në Kosovë janë të mëdha. Figura 1. prezanton shtrirjen e ekonomive shtëpiake varësisht nga madhësia e tyre.

**Figure 1: Madhësia e ekonomisë shtëpiake bujqësore**



Shumica e ekonomive shtëpiake janë me 5–8 anëtarë, 52,2 % të ekonomive shtëpiake hyjnë në këtë grup. Ekonomitë shtëpiake shumë të mëdha me 13–15 anëtarë përbëjnë 5,9 %. Mesatarja e numrit të anëtarëve për ekonomi shtëpiake është rreth 7,7. Nga numri i përgjithshëm i popullsisë bujqësore rreth 10 % jetojnë më shumë se gjashtë muaj jashtë ekonomisë shtëpiake. Numri më i madh përbëhet nga meshkujt e grup moshës 15–59 që në vitin 2004 kanë kaluar 10–12 muaj jashtë ekonomisë familjare.

Tabela 2. prezanton popullsinë bujqësore sipas komunave dhe grup moshave. Disa komuna kanë numër më të madh të njerëzve që varen nga bujqësia. Podujeva, Ferizaj, Prizreni dhe Lipjani kanë numrin më të madh të popullsisë që merret me bujqësi, mbi 50.000 në secilën komunë.

Po ashtu ekzistojnë dallime të mëdha në strukturën e moshave sipas komunës. Përqindje më e lartë e të rinjve deri 14 vjeç është e pranishme në Malishevë, 36,4%, në krahasim me mesataren e përgjithshme në nivel të Kosovës, që është 30,7%. Grup moshë e re aktive për

<sup>8</sup>Popullsia bujqësore është definuar si të gjithë anëtarët e ekonomive shtëpiake bujqësore, siç është definuar në Kaptinën 1

punë 15–29 vjeç është më e larta në Novobërdë 40,3 % e cila është një komunë e vogël me vetëm 3.000 persona që merren me bujqësi, krahasuar me mesataren në nivel të Kosovës që është 29,5 %. Pjesa e popullsisë së grup moshës kryesore për punë midis 30–49 vjeç, është e përafërsisht e ngjashme në të gjitha komunat, midis një të pestës dhe një të katërtës së popullsisë bujqësore. Pjesa e grup moshës 50–64 vjeç në Kosovë është rreth 10 % kurse për më të moshuarit (65 e më shumë vjeç) sillet rreth 6 %. Pjesa e popullsisë bujqësore e moshës mbi 50 vjeç është më e lartë në disa komuna, posaçërisht në Leposaviq 40,2 %, Zubin Potok 30,7 %, Zveçan 29,2 %, Shtërpce 25,9 %. Një nga arsyet e migrimit të rinisë është mungesa e punës dhe perspektivës së karrierës nëpër fshatra.

Table 3: Popullsia bujqësore sipas grupmoshave në komuna

Komuna	Grup mosha										Gjithsej	
	Deri 14		15 - 29		30 - 49		50 - 64		65 e më shumë			
	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
<b>Kosova</b>	<b>278.405</b>	<b>30,7</b>	<b>267.467</b>	<b>29,5</b>	<b>218.856</b>	<b>24,1</b>	<b>89.391</b>	<b>9,8</b>	<b>53.804</b>	<b>5,9</b>	<b>907.925</b>	<b>100,0</b>
Deçani	8.356	28,5	8.949	30,5	6.735	23,0	3.163	10,8	2.094	7,1	29.298	100,0
Gjakova	12.380	29,9	13.005	31,5	9.286	22,5	3.913	9,5	2.754	6,7	41.339	100,0
Gllgoci	11.127	28,5	13.616	34,8	8.975	23,0	3.760	9,6	1.594	4,1	39.072	100,0
Gjilani	11.700	29,3	10.192	25,5	10.258	25,7	5.115	12,8	2.710	6,8	39.975	100,0
Dragashi	5.647	28,6	5.189	26,3	5.224	26,5	2.217	11,2	1.462	7,4	19.739	100,0
Istogu	10.209	31,1	9.051	27,5	8.330	25,3	3.500	10,7	1.772	5,4	32.862	100,0
Kaçaniku	7.497	30,7	7.506	30,8	6.038	24,7	2.177	8,9	1.188	4,9	24.405	100,0
Klina	9.576	32,0	9.775	32,7	6.427	21,5	2.365	7,9	1.773	5,9	29.917	100,0
Fushë Kosova	4.233	27,3	4.933	31,8	3.676	23,7	1.837	11,9	822	5,3	15.501	100,0
Kamenica	6.286	26,3	6.476	27,1	6.367	26,6	2.635	11,0	2.155	9,0	23.919	100,0
Mitrovica	5.535	32,7	5.021	29,7	3.936	23,3	1.515	9,0	910	5,4	16.917	100,0
Leposaviqi	1.102	11,6	1.856	19,5	2.725	28,7	2.240	23,6	1.580	16,6	9.503	100,0
Lipjani	14.401	28,5	15.625	30,9	12.248	24,2	5.634	11,2	2.604	5,2	50.512	100,0
Novo Brda	509	17,2	1.195	40,3	620	20,9	310	10,4	332	11,2	2.965	100,0
Obiliqi	3.944	31,1	3.560	28,1	3.274	25,8	1.341	10,6	573	4,5	12.691	100,0
Rahoveci	11.061	29,8	11.090	29,8	9.613	25,9	3.446	9,3	1.947	5,2	37.157	100,0
Peja	11.071	30,2	10.652	29,0	8.747	23,8	3.852	10,5	2.356	6,4	36.678	100,0
Podujeva	17.263	31,8	16.003	29,5	13.005	24,0	5.359	9,9	2.628	4,8	54.258	100,0
Prishtina	7.167	27,1	7.448	28,1	6.763	25,6	2.848	10,8	2.241	8,5	26.467	100,0
Prizreni	17.728	33,7	14.804	28,2	13.023	24,8	4.005	7,6	2.978	5,7	52.538	100,0
Skenderaj	15.152	31,6	14.144	29,5	11.599	24,2	4.203	8,8	2.780	5,8	47.878	100,0
Shtimja	7.435	35,8	5.929	28,6	4.978	24,0	1.513	7,3	907	4,4	20.763	100,0
Shterpcë	2.553	24,7	2.280	22,1	2.827	27,4	1.246	12,1	1.429	13,8	10.335	100,0
Suha Reka	16.911	34,2	14.772	29,9	11.400	23,1	3.824	7,7	2.525	5,1	49.433	100,0
Ferizaj	18.324	34,8	14.468	27,5	12.735	24,2	4.515	8,6	2.586	4,9	52.628	100,0
Vitë	13.748	33,6	10.453	25,5	10.272	25,1	3.730	9,1	2.725	6,7	40.927	100,0
Vushtrri	10.384	26,8	13.843	35,7	8.680	22,4	4.411	11,4	1.454	3,7	38.771	100,0
Zubin Potoku	1.007	20,3	1.225	24,7	1.211	24,4	974	19,6	550	11,1	4.967	100,0
Zveçani	841	18,2	1.117	24,2	1.303	28,3	738	16,0	610	13,2	4.609	100,0
Malisheva	15.258	36,4	13.289	31,7	8.583	20,5	3.005	7,2	1.765	4,2	41.900	100,0

Tabela 4. tregon popullsinë bujqësore sipas gjinisë dhe komunës.

**Table 4: Popullsia bujqësore sipas gjinisë në komuna**

Komuna	Meshkuj		Femra		Gjithsej	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
<b>Kosova</b>	<b>477.899</b>	<b>52,6</b>	<b>430.026</b>	<b>47,4</b>	<b>907.925</b>	<b>100,0</b>
Deçani	15.581	53,2	13.716	46,8	29.298	100,0
Gjakova	22.055	53,4	19.283	46,6	41.339	100,0
Gllgoci	19.806	50,7	19.266	49,3	39.072	100,0
Gjilani	21.457	53,7	18.518	46,3	39.975	100,0
Dragashi	9.983	50,6	9.756	49,4	19.739	100,0
Istogu	16.796	51,1	16.066	48,9	32.862	100,0
Kaçaniku	13.310	54,5	11.096	45,5	24.405	100,0
Klina	15.563	52,0	14.353	48,0	29.917	100,0
Fushë Kosova	7.955	51,3	7.546	48,7	15.501	100,0
Kamenica	12.415	51,9	11.504	48,1	23.919	100,0
Mitrovica	9.163	54,2	7.754	45,8	16.917	100,0
Leposaviqi	5.288	55,6	4.215	44,4	9.503	100,0
Lipjani	27.238	53,9	23.274	46,1	50.512	100,0
Novo Brda	1.571	53,0	1.394	47,0	2965	100,0
Obiliqi	6.932	54,6	5.759	45,4	12.691	100,0
Rahoveci	19.602	52,8	17.555	47,2	37.157	100,0
Peja	18.770	51,2	17.908	48,8	36.678	100,0
Podujeva	28.836	53,1	25.422	46,9	54.258	100,0
Prishtina	13.896	52,5	12.571	47,5	26.467	100,0
Prizreni	27.586	52,5	24.952	47,5	52.538	100,0
Skenderaj	25.083	52,4	22.795	47,6	47.878	100,0
Shtimja	11.033	53,1	9.729	46,9	20.763	100,0
Shterpcë	5.502	53,2	4.833	46,8	10.335	100,0
Suha Reka	26.340	53,3	23.093	46,7	49.433	100,0
Ferizaji	27.545	52,3	25.083	47,7	52.628	100,0
Vitia	20.692	50,6	20.235	49,4	40.927	100,0
Vushtrria	20.903	53,9	17.869	46,1	38.771	100,0
Zubin Potoku	2.781	56,0	2.187	44,0	4.967	100,0
Zveçani	2315	50,2	2.293	49,8	4.609	100,0
Malisheva	21.900	52,3	19.999	47,7	41.900	100,0

Të gjitha komunat kanë më shumë meshkuj se femra. Rezultatet e vitit 2004 nuk ishin shumë të ndryshme në krahasim me ato të anketës së ekonomive shtëpiake bujqësore 2001. Nga anketa e fundit është vërejt se me përjashtim të njerëzve të moshuar ekzistonte një dominim thelbësor i meshkujve në popullsinë bujqësore. Dominimi i meshkujve në popullsinë bujqësore si duket vazhdon përkundër migrimit para dhe pas luftës që përfshiu më shumë meshkuj se sa femra. Në anketë janë mbledhur edhe të dhënat për nivelin e arsimit. Tabela 4. paraqet nivelin arsimor të popullsisë bujqësore sipas grup moshave.

**Table 5: Shkollimi i popullsisë bujqësore sipas moshës (nga 15-64 vjeç)**

Niveli i edukimit	Grup moshë						Gjithsej	
	15-29		30-49		50-64			
	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Pa shkollë	2.595	1,0	6.850	3,1	13.156	14,7	22.601	3,9
Shkolla fillore jo e kryer	17.908	6,7	11.110	5,1	21.475	24,0	50.493	8,8
Shkolla fillore e kryer	95.111	35,6	88.858	40,6	33.458	37,4	217.427	37,8
Shkolla e mesme jo e kryer	40.668	15,2	4.393	2,0	821	0,9	45.882	8,0
Shkolla e mesme e kryer	93.950	35,1	89.527	40,9	14.770	16,5	198.247	34,4
Shkolla e lartë jo e kryer	2.229	0,8	1.104	0,5	342	0,4	3.676	0,6
Shkolla e lartë e kryer	2.285	0,9	6.259	2,9	3.323	3,7	11.867	2,1
Fakulteti jo i kryer	10.589	4,0	3.240	1,5	323	0,4	14.152	2,5
Fakulteti i kryer	2.131	0,8	7.515	3,4	1.724	1,9	11.371	2,0
Gjithsej	267.467	100,0	218.856	100,0	89.391	100,0	575.715	100,0

Pjesa më e madhe e popullsisë i takon nivelit të arsimit me shkollë fillore dhe të mesme. Pjesa e këtyre dy grupeve e llogaritur bashkë përbën afër tri të katërtat e popullatës bujqësore të rritur në moshë aktive për punë. Këtyre dy ekstremeve, pa arsimim dhe me arsimim universitar të kryer, u përkasin pjesë të vogla të popullsisë, rreth 4 % në secilin grup. Ekzistojnë dallime të mëdha në nivelin arsimor në Kosovë midis meshkujve dhe femrave të popullsisë bujqësore të moshës 15-64 vjeç (Tabela 6).

**Table 6: Shkollimi i popullsisë bujqësore sipas gjinisë (nga 15-64 vjeç)**

Niveli i edukimit	Meshkuj		Femra		Gjithsej	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Pa shkollë	4.882	1,6	17.719	6,5	22.601	3,9
Shkolla fillore jo e kryer	17.899	5,9	32.594	11,9	50.493	8,8
Shkolla fillore e kryer	78.242	25,9	139.185	50,9	217.427	37,8
Shkolla e mesme jo e kryer	27.687	9,2	18.195	6,7	45.882	8,0
Shkolla e mesme e kryer	142.766	47,2	55.481	20,3	198.247	34,4
Shkolla e lartë jo e kryer	2.695	0,9	982	0,4	3.676	0,6
Shkolla e lartë e kryer	8.986	3,0	2.881	1,1	11.867	2,1
Fakulteti jo i kryer	10.313	3,4	3.838	1,4	14.152	2,5
Fakulteti i kryer	9.010	3,0	2.361	0,9	11.371	2,0
Gjithsej	302.479	100,0	273.236	100,0	575.715	100,0

Numri i femrave të paarsimuara është tri herë më i madh në krahasim me numrin meshkujve. Në përgjithësi familjet bujqësore në Kosovë shkollojnë vajzat e tyre deri në përfundim të shkollës fillore. Për këtë arsye përqindja e femrave të rritura që përfundojnë arsimin fillor është rreth 51 %, ndërsa rreth 47 % të meshkujve kanë të kryer shkollën e mesme. Ky dallim midis gjinive nuk është vetëm për shkak të prioritetit gjinor që familjet në zonat rurale iu japin djemve të tyre, por kjo po ashtu varet edhe nga distanca prej vendbanimit deri tek shkolla, kushtet e transportit, dhe nga infrastruktura fizike ekzistuese. Në ato fshatrat ku ekziston shkolla fillore të dy gjinitë dërgohen në shkollë. Në anketat tjera (LSMS 2000, LFS 2001 dhe 2002) janë hasur dallime të mëdha në shkollim midis popullsisë së zonave rurale dhe urbane.

### Mungesa e të dhënave

Regjistrimi i popullsisë do të sigurojë informata më të mira për numrin e popullsisë bujqësore dhe të strukturës gjinore në rajonet rurale.

### 3 Shfrytëzimi i tokës dhe struktura e fermës

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës në Kosovë llogaritet të jetë rreth 1.1 milion hektarë. Pjesa dërmuese e strukturës së tokës së shfrytëzuar i referohet viteve 80-ta dhe bazohet në regjistrin kadastral. Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2004 ka mbledhur informata për shfrytëzimin e secilës ngastër tokësore, në pronësi ose të shfrytëzuar, përfshirë edhe djerrinat. Duhet cekur që të dhënat e prezantuara më poshtë tregojnë sipërfaqe më të vogël tokësore sipas kategorive në krahasim me atë të raportuar më herët. Disa faktorë mund të jenë përgjegjës për këto mospërputhje. Së pari, toka e NPSH<sup>9</sup>-ve nuk është përfshirë dhe ky raport nuk i referohet kësaj toke. E dyta, definicioni i ekonomive shtëpiake bujqësore ka ndikuar në të dhënat për tokën e shfrytëzuar.

Për t'u numëruar si ekonomi shtëpiake bujqësore të njëjtat është dashur të jenë në Kosovë dhe që momentalisht të jenë duke jetuar dhe vepruar në fshat. Djerrinat janë numëruar vetëm kur ato janë raportuar si të tilla nga ekonomitë shtëpiake bujqësore. Sipërfaqja tokësore e braktisur nga ekonomitë shtëpiake që jetojnë jashtë Kosovës ose nga personat e zhvendosur nuk është numëruar. Një arsye tjetër e mundshme është mos paraqitja e ngastrave për shkak të frikës nga tatimi në të ardhmen.

Për më tepër është e njohur që sipërfaqe mjaft të mëdha të tokave bujqësore në vitet e fundit janë humbur për shkak të shfrytëzimit të tyre për ndërtime. Përfundimisht madhësia e vogël e mostrës po ashtu mund të ishte një nga faktorët. Sidoqoftë, vlen të përmendet se përvoja e shteteve tjera në tranzicion në ekonomi të tregut ka treguar që të dhënat e vjetra nga sistemi i planifikimit qendror shpesh kanë mbivlerësuar disponueshmërinë e tokës së fermës pasi që nuk është bërë përshtatja sa i përket humbjeve thelbësore të sipërfaqes së tokës për qëllim të përdorimit jo bujqësor. Tabela 7. prezanton shfrytëzimin e tokës ashtu siç është raportuar nga fermerët.


**Table 7: Shfrytëzimi i tokës**

Lloji i tokës	Sipërfaqja (ha)	%
Ara	114.162	43,19
Kopshte	2.253	0,85
Pemishte	3.088	1,17
Vreshta	980	0,37
Serra	189	0,07
Livadhe	55.601	21,03
Nën-totali i tokës së kultivuar	176.273	66,68
Kullosa	4.975	1,88
Djerrinë	15.750	5,96
Nën-totali i tokës bujqësore	196.997	74,52
Oborri i shtëpisë	9.136	3,46
Male	58.097	21,98
Të tjera	109	0,04
Gjithsej sipërfaqja tokësore	264.340	100,0

Toka bujqësore në pronësi apo e shfrytëzuar nga ekonomia shtëpiake llogaritet të jetë 75 % nga e tërë sipërfaqja e tokës. Pjesa tjetër e tokës është male dhe oborr i shtëpive. Toka bujqësore përfshin arat, kopshtet, serrat, livadhet, kullosat, dhe djerrinat. Shfrytëzimi i tokës bujqësore sipas kategorive kryesore është prezantuar në Figurën 2.


<sup>9</sup> Agrokombinatet, Ndërmarrjet Bujqësore dhe Kooperativat

Figure 2: Shfrytëzimi i tokës bujqësore



Pjesa më e madhe, 58 %, i takon kategorisë së arave; kategoria e dytë sipas madhësisë përbëhet nga kullosat dhe livadhet. Sipas anketës së ekonomive shtëpiake bujqësore 2004, 8 % e tokës bujqësore është e lënë djerrinë. Në vitin 2004, një e katërta e të gjitha ekonomive shtëpiake bujqësore kanë pasur një pjesë të tokës të lënë djerrinë. Rreth një e treta e fermerëve që kanë pasur djerrina theksojnë se kjo është bërë për shkak të fitimit të ulët ekonomik. Shih Figurën 3.

Figure 3: Arsyet e dhëna nga fermerët për tokën e lënë djerrinë<sup>10</sup>



Arsyet tjera të rëndësishme janë mungesa e të hyrave, pajisjeve apo fuqisë punëtore. Edhe pse mesatarisht ekonomitë shtëpiake bujqësore kanë mjaft pajisje për sipërfaqet e kultivuara dhe tepriçë të fuqisë punëtore, për disa ekonomi shtëpiake këto paraqiten si pengesë

<sup>10</sup> Njëra prej arsyeve është mungesa e sigurisë e cila ju referohet fermerëve të cilët janë të brengosur për sigurinë e tyre personale.

Table 8: Ujitja e tokës së kultivuar sipas komunave

Komuna	Të ujitura	Të pa ujitura	Gjithsej	Pjesëmarrja e komunave në sipërfaqet e ujitura
	%	%	%	%
<b>Kosovo</b>	<b>31,5</b>	<b>68,5</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>
Decan	67,5	32,5	100,0	7,2
Gjakova	34,6	65,4	100,0	4,3
Glllogoc	33,3	66,7	100,0	4,9
Gjilan	30,4	69,6	100,0	4,8
Dragash	5,4	94,6	100,0	0,3
Istog	54,4	45,6	100,0	5,9
Kachanik	32,1	67,9	100,0	2,3
Kline	25,3	74,7	100,0	2,1
Fushë Kosovo	33,6	66,4	100,0	2,6
Kamenica	26,5	73,5	100,0	3,7
Mitrovica	27,3	72,7	100,0	1,3
Leposavic	37,8	62,2	100,0	3,6
Lipjan	21,0	79,0	100,0	3,8
Novo Brde	21,2	78,8	100,0	0,4
Obiliq	27,2	72,8	100,0	1,3
Rahovec	43,3	56,7	100,0	5,8
Peje	69,5	30,5	100,0	8,9
Podujevo	25,2	74,8	100,0	5,6
Prishtina	30,3	69,7	100,0	4,2
Prizren	30,8	69,2	100,0	3,6
Skenderaj	15,1	84,9	100,0	1,9
Shtime	23,2	76,8	100,0	1,4
Shterpce	38,1	61,9	100,0	3,0
Suha Reka	25,8	74,2	100,0	3,9
Ferizai	19,4	80,6	100,0	2,8
Viti	23,6	76,4	100,0	2,8
Vushtrri	31,1	68,9	100,0	3,7
Zubin Potok	40,7	59,3	100,0	1,1
Zvecan	53,2	46,8	100,0	1,7
Malisheva	9,7	90,3	100,0	1,1

Ujitja bëhet në rreth 33.000 ha ose rreth 32 % të tokës së kultivuar. Tabela 8. prezanton ndarjen e tokës së ujitur sipas komunave siç është raportuar nga fermerët. Struktura e fermës është e dominuar nga fermat e vogla familjare, që në mënyrë tipike posedojnë më pak se dy hektarë, e që prodhojnë për nevoja familjare. Në vitin 2004 janë identifikuar 369 ekonomi të mëdha familjare private, përfshirë njësitë e specializuara. Këto kanë pasur rreth 9.400 ha të sipërfaqes tokësore, ose 3,6 % të të gjithë tokës private të raportuar nga fermerët.



Table 9: Toka bujqësore sipas madhësisë së fermës dhe strukturës së fermës

Madhësia e fermës në (ha)	Fermat e vogla			Fermat e mëdha			Gjithsej			
	Numri i fermave	Sipërfaqja (ha)	% e fermave	Numri i fermave	Sipërfaqja (ha)	% e fermave	Numri i fermave	Sipërfaqja (ha)	% e fermave	% Kumulative
0 - 0.5 ha	27.503	8.305	23,5	9	3	2,4	27.512	8.308	23,4	23,4
0.51 - 1 ha	27.379	20.808	23,4	10	7	2,7	27.389	20.815	23,3	46,8
1.01 - 2 ha	32.646	47.813	27,9	20	33	5,4	32.666	47.846	27,8	74,6
2.01 - 3 ha	14.907	36.311	12,7	30	73	8,1	14.937	36.384	12,7	87,3
3.01 - 4 ha	6.678	22.986	5,7	42	148	11,4	6.720	23.134	5,7	93,1
4.01 - 5 ha	3.294	14.769	2,8	31	139	8,4	3.325	14.908	2,8	95,9
5.01 - 6 ha	1.898	10.346	1,6	29	161	7,9	1.927	10.507	1,6	97,5
6.01 - 8 ha	1.389	9.783	1,2	42	294	11,4	1.431	10.077	1,2	98,8
8.01 - 10 ha	477	4.193	0,4	29	257	7,9	506	4.451	0,4	99,2
Mbi 10 ha	826	12.715	0,7	127	7.851	34,4	953	20.567	0,8	100,0
Gjithsej	116.998	188.031	100,0	369	8.966	100,0	117.367	196.997	100,0	

Tabela 9. paraqet shpërndarjen e fermave sipas madhësisë, fermave të mëdha dhe atyre të vogla. Fermat janë klasifikuar në 10 grupe sipas madhësisë. 96 % të ekonomive shtëpiake janë nën 5 ha, dhe këto zënë 80 % të sipërfaqes bujqësore tek fermat e vogla, derisa 4 % të fermave me mbi 5 ha zënë 20 % të tokës. Në vitin 2004 madhësia mesatare e fermës të ekonomitë e vogla shtëpiake ishte 1,6 ha duke llogaritur vetëm tokën bujqësore. Devijimi standard ishte më i vogël se sa tek fermat e mëdha, 2,1. Kjo strukturë shumë e fragmentuar e fermës pengon zhvillimin e bujqësisë komerciale dhe përjetëson bujqësinë ekzistenciale. Shtrirja e fermave të mëdha dhe të specializuara qëndron plotësisht ndryshe. Madhësia mesatare e fermës ishte 24,3 ha me devijim standard prej 76,6. Nën 5 ha janë 38 % të fermave por sipërfaqja e tokës bujqësore në këto ferma numëron vetëm 4 % të tokës bujqësore në fermat e mëdha, derisa 62 % të fermave janë me mbi 5 ha. Ky grup përbën 96 % të tokës. Në këtë grup janë pak ferma të mëdha me kullosa ekstensive. Duke pasur parasysh numrin dhe sipërfaqen e tokës që i përket fermave të vogla, shtrirja e përgjithshme sipas madhësisë së tokës bujqësore në Kosovë është gati identike me shtrirjen e fermave të vogla të ekonomive shtëpiake.

Tabela 10. paraqet shfrytëzimin e tokës bujqësore sipas kategorive në fermat e vogla dhe të mëdha. Dallimet midis këtyre dy grupeve të fermave janë substanciale. Në fermat e vogla kategoria e arave është gati mbi një të tretën e sipërfaqes së përgjithshme të tokës, derisa në fermat e mëdha është gati gjysma. Në fermat e vogla kopshtet dhe oborret e shtëpive zënë rreth 4,5 % nga e tërë sipërfaqja e tokës. Ky është një tregues tjetër i karakterit të tyre ekzistencial dhe jo komercial.

**Table 10: Sipërfaqja e përgjithshme e tokës sipas shfrytëzueshmërisë dhe strukturës së fermës**

Lloji i tokës	Fermat e vogla		Fermat e mëdha	
	Sipërfaqja (ha)	%	Sipërfaqja (ha)	%
Ara	109.028	42,77	5.134	54,6
Kopshte	2.248	0,88	5	0,05
Pemishte	2.966	1,16	122	1,29
Vreshta	731	0,29	248	2,64
Serra	173	0,07	16	0,17
Livadhe	54.088	21,22	1.514	16,1
Nën-totali i tokës së kultivuar	169.234	66,38	7.038	74,85
Kullosa	3.092	1,21	1.883	20,02
Djerrinë	15.705	6,16	44	0,47
Nën-totali i tokës bujqësore	188.031	73,76	8.966	95,34
Oborri i shtëpisë	9.092	3,57	44	0,47
Male	57.720	22,64	377	4,01
Të tjera	92	0,04	17	0,18
Gjithsej sipërfaqja tokësore	254.937	100	9.403	100,0

Gati gjysma e sipërfaqes së tokës në të dy llojet e fermave është nën kullosa, livadhe dhe pyje. Përqindja e sipërfaqes së tokës së lënë djerrinë është më e madhe tek fermat e vogla. Shpesh këto ferma kanë burime tjera të të ardhurave dhe i kushtojnë më pak kohë aktiviteteve bujqësore. Situata në ferma të mëdha është ndryshe pasi që këta fermerë mbështeten kryesisht në të ardhurat nga ferma për të mbajtur ekonomitë e tyre shtëpiake.

**Table 11: Toka bujqësore sipas statusit pronësor dhe strukturës së fermës**

Statusi pronësor	Fermat e vogla		Fermat e mëdha		Gjithsej	
	Sipërfaqja (ha)	%	Sipërfaqja (ha)	%	Sipërfaqja (ha)	%
Pronë	175.096	97,3	2.016	79,5	177.112	97,2
E marrë me qira	8.238	1,7	4.445	18,9	12.682	1,8
E shfrytëzuar pa kompensim nga personat privat	3.939	0,8	1.274	0,8	5.214	0,8
Pronë shtetërore	652	0,1	674	0,6	1.326	0,1
Të tjera	106	0,1	556	0,2	662	0,1
Gjithsej	188.031	100,0	8.966	100,0	196.997	100,0

Gjatë anketës së ekonomive shtëpiake bujqësore 2004, janë mbledhur informata për statusin pronësor të ngastrave. Tabela 3.5 tregon se në fermat e vogla gati e tërë sipërfaqja tokësore është pronë private. Fermat e mëdha përdorin më shumë toka të marra me qira.

### Mungesa e të dhënave


Gjatë përdorimit të të dhënave duhet pasur parasysh kufizimet në saktësinë e mostrës së vogël. Për këtë arsye të dhënat në nivel komunal nuk janë paraqitur.

## 4 Kulturat bujqësore

Kosova është një vend pothuajse në tërësi i rrethuar me male. Sipërfaqet kryesore të tokës së punueshme gjenden nëpër luginat dhe rrafshinat kryesisht në veri dhe lindje. Prodhimtaria e perimeve dhe e pemëve është e koncentruar më së shumti në perëndim të vendit. Ekzistojnë kullosa ekstensive, kullosat dhe pyjet të shtrira në pjesët malore.

Ky kapitull paraqet sipërfaqet e kultivuara sipas kulturave (në hektarë); prodhimtarinë dhe rendimentin në tonelata. Figura 4.1 paraqet kulturat kryesore bujqësore të kultivuara në vitin 2004, grupuar në pesë kategori: drithëra, bimë foragjere, perime, pemë dhe të tjera<sup>11</sup>.

Figure 4: Sipërfaqja me kultura sipas kategorive



Rezultatet e anketës tregojnë që drithërat dhe bimët foragjere përbëjnë sipërfaqet më të mëdha të tokës së kultivuar në Kosovë, rreth 90 %. Ndërsa pemët dhe perimet përbëjnë përafërsisht 10 % të sipërfaqes së mbetur të tokës së kultivuar.

Në vitin 2004 kanë mbizotëruar kushte të favorshme agroklimatike. Kjo është reflektuar në prodhimtarinë e përgjithshme dhe në rendimente. Tabela 12. tregon sipërfaqet e mbjellura, prodhimtarinë dhe rendimentin sipas kulturave.

<sup>11</sup> Bimët industriale, Fidanet

Table 12: Sipërfaqja me kultura, prodhimtaria dhe rendimenti

Kulturat	Sipërfaqja (ha)	Prodhimtaria (t)	Rendimenti (t/ha)	Kulturat	Sipërfaqja (ha)	Prodhimtaria (t)	Rendimenti (t/ha)
Drithërat	83.492			Bimët foragjere	77.046		
Grurë	52.156	196.693	3,7	Grurë (i gjelbërt)	103	401	3,8
Thekër	337	980	2,9	Thekër (e gjelbërt)	778	1.999	2,5
Elb	2.221	6.297	2,8	Elb (i gjelbërt)	61	184	3,0
Elb birre	846	2.731	3,2	Tërshërë (e gjelbërt)	3.409	8.675	2,5
Tërshërë	2.336	4.963	2,1	Misër (i gjelbërt)	1.195	21.407	17,9
Misër	25.596	91.671	3,5	Sanë ( livadhi )	51.676	132.330	2,5
Perimet	11.738			Përzjerje e barit	2.959	9.485	3,2
Patate	2.526	55.881	22,1	Jonxhë	14.049	45.328	3,2
Domate	606	11.261	18,5	Tërfil	2.607	8.738	3,3
Patëllxhan i zi	10	256	25,1	Urov	209	768	3,6
Speca	2.040	39.883	19,5	Pemët	3.889		
Kunguj	849	6.115	7,2	Mollë	674	9.141	13,5
Kunguj Misir	60	868	14,3	Dardhë	227	2.781	12,2
Tranguj	202	5.889	29,2	Ftua	34	580	17,2
Shalqi	527	9.963	18,8	Mushmollë	10	171	16,2
Pjepër	103	1.463	14,2	Kumbull	1.691	16.136	9,5
Lakër	570	15.419	27,0	Kajsi	26	352	13,2
Lulelakër	7	124	18,8	Pjeshkë	17	209	12,1
Spinaq	42	343	8,1	Qersh	41	415	10,1
Sallatë	27	262	9,6	Vishnje	38	356	9,4
Panxhar i kuq	12	301	24,2	Arra	54	1.019	18,8
Majdanoz	5	28	6,0	Lajthi	7	21	3,0
Preshi (Purri)	51	870	17,1	Gështenjë	162	750	4,6
Qepë	661	9.920	15,0	Dredhëza	14	58	4,1
Rillkë	0	5	10,9	Mjedër	2	4	1,5
Hudhër	87	500	5,7	Rrush vere	301	1.422	3,7
Fasule	3.275	5.253	1,6	Rrush tryeze	591	2.658	4,5
Bizele	16	36	2,3	Të tjera	102		
Bishtajë(fas.nj)	27	63	2,3				
Karota	35	427	12,0				

Kjo tabelë tregon se gruri dhe misri janë kulturat më të rëndësishme në Kosovë sa i përket sipërfaqeve të mbjella dhe sasisë së korrur. Perimet më dominuese ishin fasulja, patatja dhe speci, ndërsa për bimë foragjere, sana (livadhe) dhe jonxha. Pemët më dominuese janë kumbullat, mollët dhe rrushi. Tabela po ashtu tregon rendimente të mira në vitin 2004 për kulturat si: gruri, misri, patatja, fasulja dhe speci.

Disa komuna janë të njohura për kultivimin e llojeve të caktuara të kulturave. Kjo është reflektuar edhe në rezultatet e anketës. Komunitat e Lipjanit, Klinës dhe Ferizajt kanë prodhimtarinë më të lartë të grurit dhe të misrit. Komunitat e Vushtrrisë, Pejës dhe Istogut janë prodhuesit kryesor të patates dhe të domates. Komuna e Rahovecit është e njohur për vreshta dhe ka prodhimtarinë më të lartë të rrushit. Komunitat e Rahovecit, Pejës dhe Prizrenit janë prodhuesit më të rëndësishëm të specit, ndërsa Istogu, Peja dhe Suhareka për prodhimtari të mollës, kurse komunitat Laposaviq, Zveçan dhe Zubin Potoku për prodhimin e kumbullës.

## 5 Pylltaria

Pylltaria është një sektor i rëndësishëm në Kosovë për arsye ekonomike, ambientale dhe sociale. Legjislacioni i ri për menaxhimin e pyjeve është futur në përdorim para pak kohe në bazë të konventës ndërkombëtare<sup>12</sup>. Në anketën bujqësore 2004 është mbledhur informata nga ekonomitë shtëpiake mbi shpërndarjen e pyjeve në sektorin privat, shfrytëzimin e drurit sipas komunave dhe llojet e drurit të shfrytëzuar<sup>13</sup>.

Tabela 13. paraqet numrin e ekonomive shtëpiake bujqësore që posedojnë pyje sipas komunave, shprehur si përqindje e numrit të përgjithshëm të ekonomive shtëpiake bujqësore në secilën komunë.

**Table 13: Numri i ekonomive shtëpiake që posedojnë pyje sipas komunave**

Komuna	Gjithsej ESH	ESH me pyje	%
Kosova	117.967	56.198	48
Deçani	3.987	1.146	29
Gjakova	5.307	3.644	69
Glogoci	5.191	3.863	74
Gjilani	6.256	2.905	46
Dragashi	2.739	720	26
Istogu	4.211	1.608	38
Kaçaniku	2.923	2.011	69
Klina	3.323	2.253	68
Fushë Kosova	2.322	338	15
Kamenica	4.258	2.502	59
Mitrovica	2.319	1.096	47
Leposaviqi	2.675	2.263	85
Lipjani	6.667	1.768	27
Novo Brda	531	465	88
Obiliqi	1.697	406	24
Rahoveci	3.714	1.691	46
Peja	5.299	1.545	29
Podujeva	6.736	3.134	47
Prishtina	4.597	1.840	40
Prizreni	5.953	2.720	46
Skenderaj	5.297	4.106	78
Shtimja	2.185	1.094	50
Shterpca	1.763	395	22
Suha Reka	5.181	2.721	53
Ferizaji	6.314	3.126	50
Vitia	5.190	1.105	21
Vushtrria	4.939	1.352	27
Zubin Potoku	1.132	1.005	89
Zveçani	1.010	926	92
Malisheva	4.251	2.450	58

Tabela 13. tregon se komuna e Zveçanit, Zubin Potokut, dhe Novobërdës kanë përqindje më të lartë të ekonomive shtëpiake me pyje (92%, 89% dhe 88%). Territori i këtyre komunave është i njohur si territor malor.

Prandaj rëndësia e pyjeve në këto zona është shumë e lartë dhe në shumicën e rasteve është burimi kryesor i të ardhurave për ekonomitë shtëpiake bujqësore. Përqindje më e ultë

<sup>12</sup> Ligji për pyjet e Kosovës është miratuar në vitin 2003, në bazë të të cilit Kosova do të menaxhojë pyjet e sajë në bazë të aneksit III të raportit të Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (Rio De Jeneiro, 3–14 Qershor 1992).

<sup>13</sup> Informata shtesë lidhur me pylltarinë e Kosovës mund të sigurohen nga MBPZHR, Departamenti i Pylltarisë respektivisht të dhënat e mbledhura nga "Inventarizimi i Pyjeve"

e ekonomive shtëpiake të cilat posedojnë sipërfaqe pyjore ka dale në komunat e Fushë-Kosovës (15 %) dhe Vitisë (21 %). Në komunën e Vitisë, shumica e pyjeve janë në pronësi shtetërore në krahasim me pronën private. Tabela 14. tregon shfrytëzimin e drurit sipas komunave.


**Table 14: Sasia dhe qëllimi i shfrytëzimit të drurit sipas komunave**

Komuna	Sasia e shfrytëzuar m3	Qëllimi i shfrytëzimit, %		
		Teknik	Industrial	Për djegje
Kosova	434.336	0,9	0,7	98,4
Deçani	5.030	4,5	:	95,5
Gjakova	27.561	:	0,5	99,5
Gllgoc	12.803	:	:	100,0
Gjilani	19.167	:	:	100,0
Dragashi	2.276	:	:	100,0
Istogu	7.092	2,2	:	97,8
Kaçaniku	15.093	:	:	100,0
Klina	24.042	:	:	100,0
Fushë Kosova	2.224	:	:	100,0
Kamenica	17.708	7,5	:	92,5
Mitrovica	12.665	0,5	:	99,5
Leposaviqi	28.387	:	:	100,0
Lipjani	25.316	:	1,1	98,9
Novo Brda	8.562	:	:	100,0
Obiliqi	2.935	:	:	100,0
Rahoveci	10.851	:	:	100,0
Peja	12.755	14,7	6,4	78,9
Podujeva	29.583	0,5	:	99,5
Prishtina	16.604	0,2	:	99,8
Prizreni	7.186	:	:	100,0
Skenderaj	32.580	0,2	1,0	98,8
Shtimja	10.731	:	:	100,0
Shterpca	2.645	:	:	100,0
Suha Reka	15.057	:	5,4	94,6
Ferizaji	31.525	:	:	100,0
Vitia	7.170	:	:	100,0
Vushtrria	10.021	:	:	100,0
Zubin Potoku	14.223	:	:	100,0
Zveçani	9.322	:	2,3	97,7
Malisheva	13.222	:	:	100,0

Shfrytëzimi më i lartë i drurit në ekonomitë shtëpiake bujqësore është në komunën e Skenderajt dhe në Ferizaj. Në këto komuna shitja e drurit për ngrohje siguron një burim të rëndësishëm të të ardhurave të ekonomive shtëpiake bujqësore.

Figura 5. paraqet shfrytëzimin e pyjeve të poseduara nga sektori privat.

**Figure 5: Shfrytëzimi i pyjeve**



Shumica e lëndës drunore është përdorur për djegie, 98 %, ndërsa vetëm 2 % për qëllime teknike dhe industriale<sup>14</sup>. Kjo është pritur, duke ditur që shumica e pyjeve në Kosovë janë pyje të ulëta, jo të përshtatshme për prodhim apo përdorim teknik-industrial. Të dhënat e njëjta lidhur më shfrytëzimin e drurit sipas komunave janë paraqitur edhe në tabelën paraprake 14. Tabela 15. paraqet llojet e drurit në Kosovë.


**Table 15: Llojet e drurit**

Lloji i drurit	(%)
Hormoq	3,18
Bredh i bardhë	1,01
Pishë e bardhë	0,18
Pishë e zezë	0,03
Halorë tjerë	0,17
Ah	16,75
Dushqet (bung, qarr...)	77,53
Gjethore tjera të forta	0,74
Gjethore tjera të buta (shelg,plep...)	0,41
Gjithsej	100,0

Është e qartë nga tabela dhe nga figura 6. që është më poshtë se drunjat më të rëndësishëm janë dushqet (gjinia Quercus)-77 %, pastaj Ahu (gj. Fagus) me 17 % dhe halorët (gj. Pinus, Abies, Picea, etj) me 5 % .

<sup>14</sup> Shtylla elektrike, lidhëse hekurudhe, mobilje, dysHEME dhe tanin dhe tapë nga lëvorja e drurit.

Figure 6: Llojet e drurit



## 6 Blegtoria

Në anketën e ekonomive shtëpiake bujqësore 2004, janë mbledhur të dhënat mbi numrin e kafshëve sipas madhësisë së fermës, e vogël apo e madhe. Nuk janë mbledhur të dhëna mbi prodhimtarinë blegtorale. Në Kosovë ekziston një numër relativisht i madh i ekonomive shtëpiake bujqësore të specializuara për blegtori. Ato janë paraqitur në tabelë nën emrin fermat e mëdha. Të dhënat për vitin 2003 vijnë nga anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2004. Kjo prezanton perceptimin sipas kujtesës së fermerëve lidhur me numrin e kafshëve që ata kanë pasur një vit më parë pasi që shumë pak prej tyre mbajnë shënime. Për këtë arsye, informacioni mund të ndryshojë nga të dhënat e vitit 2003 të marra/siguruara nga burime tjera<sup>15</sup>. Tabela 16. tregon numrin e kafshëve në vitin 2004 dhe 2003, si dhe ndryshimet në përqindje midis vitit 2003 dhe 2004.

Table 16: Prezantimi numerik i blegtorisë në Nëntor – Dhjetor 2004

Lloji i kafshëve	2003		2004		Indeksi	
	Fermat e vogla	Fermat e mëdha	Fermat e vogla	Fermat e mëdha	Fermat e vogla	Fermat e mëdha
Gjedhe	233.892	5.120	236.076	4.671	101	91
Lopë qumështore	139.680	2.656	126.691	2.616	91	98
Gjedhe tjera	94.212	2.464	109.385	2.055	116	83
Derrat	39.320	1.889	33.836	1.396	86	74
Dosa për mbarsim	16.699	905	10.546	983	63	109
Delet	55.407	26.487	53.359	18.580	96	70
Dele për riprodhim	43.117	15.393	39.117	13.336	91	87
Dhitë	13.247	1.878	9.386	1.429	71	76
Kuaj dhe gomarë	6.300	111	6.534	116	104	105
Shpezë	1.721.755	393.749	1.281.151	379.286	74	96
Pula	1.668.594	391.451	1.238.214	378.475	74	97
Shpezë tjera	53.161	2.298	42.937	811	81	35
Bletë (koshere)	39.698	718	40.918	505	103	70

<sup>15</sup> Regjistrimi i përgjithshëm i blegtorisë në vitin 2003 dhe Anketa administrative gjashtëmujore.



Gjedhet paraqesin kategorinë e kafshëve kryesore, nga e cila kategori rreth 54 % janë lopë qumështore. Ekonomitë shtëpiake kanë pasur një numër të vogël të buallicave, rreth 500 krerë në vitin 2004, që janë përfshirë në shumën e përgjithshme të gjedheve. Në vitin 2004 vetëm 2 % të gjedheve ishin në fermat e mëdha të specializuara. Gjodhet janë shumë të shpërndara midis ekonomive shtëpiake. Numri mesatar i gjedheve për ekonomi shtëpiake është 1,12 krerë për ferma të vogla dhe 15 për ferma të mëdha. Numri mesatar i lopëve qumështore për ekonomi shtëpiake të cilat kanë lopë qumështore është 1,57 në ferma të vogla, respektivisht 8.5 në fermat e mëdha. Shpërndarja është tipik edhe për llojet tjera të kafshëve. Fermat e vogla kanë mesatarisht 14 dele dhe 17 pula, ndërsa fermat e mëdha kanë 224 dele respektivisht 1.686 pula<sup>16</sup>. Këto statistika nënvizojnë karakterin ekzistencial të sektorit të blegtorisë në ekonomitë e vogla shtëpiake. Gati të gjitha kategoritë e blegtorisë treguan një rënie në fund të vitit 2004 në krahasim me periudhën e njëjtë të 2003. Përrjashtim të dukshëm nga kjo tendencë paraqesin gjedhet, kuajt dhe bletët në ferma të vogla dhe kuajt e dosat në ferma të mëdha.

Janë disa faktorë që kontribuuan në zvogëlimin e numrit të kafshëve në vitin 2004. Viti 2003 ishte vit i thatë në Kosovë dhe në Ballkan, në përgjithësi. Kjo zvogëloi furnizimin dhe rriti çmimet e ushqimit të kafshëve dhe drithërave. Sektori që u godit më së shumti nga kostoja e ngritur ishte shpezëtaria. Rënie e madhe numerike u regjistrua në fermat e vogla. Përkundër kësaj rënie numerike, sektori ishte ende më i madh në krahasim me të dhënat e vitit 2000 të marra nga moduli i bujqësisë në AMSJ. Sektori i deleve po ashtu është goditur, posaçërisht fermat e mëdha që tentuan të gjejnë tregun për produktet e tyre. Ka pasur vështirësi për të gjetur tregje, posaçërisht për eksport, dhe shumë fermer qenë të detyruar të zvogëlojnë tufat e tyre ose të qojnë duar nga ky aktivitet. Sektori i blegtorisë në Kosovë po ashtu është ballafaquar me konkurrencën të fortë nga importi.

Në nivel komunal, Gjakova, Peja, Suhareka, Prizreni, Istogu, Glllogoci, Deçani, Malisheva, Podujeva, Ferizaj, Skenderaj, Vushtrria kanë numrin më të madh të gjedhëve. Koncentrim më i madh i shpezëtarisë është në Lipjan dhe Gjakovë.

### **Mungesa e të dhënave**

Nevojitet një mostër më e madhe për vlerësim adekuat. Numri i vogël i kafshëve në nivel komunal nuk mund të arrihet me madhësinë e tanishme të mostrës.

---

<sup>16</sup> Këto mesatare për fermat e mëdha përfaqësojnë mesataren e të gjitha fermave të mëdha dhe nuk janë të kufizuara në fermat e specializuara për prodhim të qumështit ose fermave të pulave.

## 7 Inputet bujqësore

Në Anketën e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2004, është bërë mbledhja e të dhënave edhe për inputet bujqësore, kryesisht për makinerinë dhe pajisjet bujqësore, plehun mineral dhe organik. Nuk janë mbledhur të dhëna sa i përket shfrytëzimit të pajisjeve, kostos operative apo pajisjet e marra me qira. Po ashtu nuk janë mbledhur të dhënat për çmimet e plehrave mineral ose shfrytëzimin e inputeve tjera. Inputi i fuqisë punëtore është diskutuar ndaras në kapitullin 8.

### Makineria bujqësore dhe pajisjet

Është bërë mbledhja e të dhënave lidhur me numrin e makinerisë dhe pajisjeve, dhe numrin e ekonomive shtëpiake që posedojnë makineri të ndryshme. Vlerat e të dhënave të paraqitura si çmimi mesatar për njësi i referohet vlerësimit të pronarit për vlerën e makinerisë se sa do të fitonte ai për atë makinë nëse do ta shiste të njëjtën. Sikurse edhe në anketat tjera të ekonomive shtëpiake bujqësore, supozohet që vlerësimi i pronarëve për arsye të ndryshme ka tendenca të nënvlerësimit të vlerës së makinës.

**Table 17: Makineria dhe pajisjet në ekonomitë shtëpiake bujqësore<sup>17</sup>**

Lloji i makinerisë	Fermat e vogla			Fermat e mëdha		
	Numri i pajisjeve në pronësi	% e fermave që posedojnë makineri	Çmimi mesatar për njësi	Numri i pajisjeve në pronësi	% e fermave që posedojnë makineri	Çmimi mesatar për njësi
Traktor i madh (mbi 40 KF)	16.441	13,6	3.515	277	49,7	4.121
Traktor i vogël (nën 40KF)	30.952	26,1	3.056	199	47,3	3.446
Moto kultivator	8.965	7,4	1.252	143	32,4	1.253
Plug	39.637	32,5	245	416	74,7	315
Diskor ( lesë me disqe )	10.011	8,5	306	125	30,3	470
Dhëmbëzore ( lesë me dhëmbë )	17.324	14,7	233	213	49,7	300
Rimorkio	32.271	27,1	751	330	69,7	989
Makinë mbjellëse	4.431	3,4	681	146	28,5	932
Frezë përzierëse	4.106	3,4	510	157	37,2	736
Shpërndarës i plehut	2.065	1,7	330	123	28,5	435
Makinë spërkatëse	1.605	1,4	490	115	27,7	594
Makinë kositëse	7.497	6,2	504	137	31,6	745
Makinë-grabujë për bar	2.896	2,3	442	96	22,1	515
Kombajnë për korrje	877	0,6	5.482	56	10,1	5.739
Lidhëse të ushqimit të kafshëve	868	0,7	3.297	62	15,7	3.682
Makinë shirëse	184	0,2	183	2	0,5	225
Mulli <sup>17</sup>	4.478	3,7	544	107	25,8	3.308
Pompë uji	4.001	3,3	324	160	31,4	633
Aparat për mjeljen e lopëve	731	0,6	387	92	15,4	787
Të tjera	2.324	2,0	658	78	15,2	3.606

Fermerët posedojnë një numër mjaft të madh të traktorëve. Krahasimi midis fermave të vogla dhe të mëdha, paraqitur në Tabelën 17, tregon se rreth 40 % të fermave të vogla posedojnë një traktor, derisa kjo përqindje tek fermat e mëdha është 97 %.

Duke pasur parasysh ngastrat e vogla të tokës së punueshme në fermat e vogla, dallimi në krahasim me ferma të mëdha nuk është befasues, pasi që fermerët e vegjël mund të shfrytëzojnë shërbimet e kontraktuara të makinerisë apo të marrin makina me qira në vend se t'i blejnë ato makina. Ata po ashtu ballafaqohen edhe me pengesa financiare.

<sup>17</sup> Ketu jane pershire mullinjet e llojeve te ndryshme pa ndonje dallim

Shumica e traktorëve të poseduar nga fermat e vogla janë nën 40 kalë fuqi. Shumica e pronarëve të makinave posedojnë plug, lesë dhe rimorkio. Posedimi i llojeve tjera të makinerisë është mjaft i rrallë. Edhe pse kombajnët posedohen rrallë, anketa tregoi se ka rreth 930 copë sosh në Kosovë. Dhjetë % të fermave të mëdha dhe të specializuara posedojnë kombajnë. Pajisjet në dispozicion, sa i përket sasisë, pasi që të dhënat për vjetërsinë e makinave nuk janë mbledhur, duket se janë të mjaftueshme për sipërfaqet e kultivuara. Edhe pse shumë më të mekanizuara, fermat e përbëjnë dallim të vogël në numrin e makinerisë së poseduar në nivel të Kosovës.

Për tipin e njëjtë të makinerisë dhe pajisjes, vlerat për njësi shpesh janë më të lartë në fermat e mëdha se sa në fermat e vogla. Fermerët e mëdhenj posedojnë pajisje më të fuqishme, më të shtrenjta, dhe të mirëmbajtura më mirë.

### Përdorimi i plehrave minerale dhe organike

Tabela 18. paraqet përqindjen e ekonomive shtëpiake që përdorin lloje të ndryshme të plehrave minerale. Plehrat minerale përdoren nga shumica e fermerëve. NPK, zakonisht përdoret si plehërim bazë gjatë mbjelljes, dhe është një nga plehrat minerale që është përdorur më së shumti nga të gjithë plehrat mineral, ndërsa plehrat e tjerë mineral që më së shumti përdoren janë NAG dhe Ure, që zakonisht përdoren më vonë si plehërim plotësues pas mbirjes së bimëve. NPK përdoret nga 75 % e fermave të vogla dhe 85 % e fermave të mëdha. Duhet theksuar që një ekonomi shtëpiake ka përdorur plehra mineral të llojeve të ndryshëm.

**Table 18: Përdorimi i plehrave minerale dhe organike sipas ekonomive shtëpiake<sup>18</sup>**

Lloji i plehut	Fermat e vogla	Fermat e mëdha
	%	%
NPK	75,8	85,1
NAG	34,9	48,4
URE	31,3	36,7
Të tjera	1,8	1,6
Plehu organik	54,3	68,8

Gjithsej 20 % të fermave të vogla dhe 13 % të fermave të mëdha nuk përdorin asnjë lloj të plehut mineral. Rreth 50 % e fermave të vogla dhe 33 % e fermave të mëdha nuk përdorin fare pleh organik. Vetëm rreth 10 % të fermave nuk përdorin as pleh mineral as organik. Për dallim nga fermat e vogla, pjesa dërmuese e fermave të mëdha përdorin plehrat mineral dhe/ose organik. Arsyet kryesore janë kapaciteti financiar i fermave të mëdha për të blerë inpute dhe aplikimi më përpiktë i teknologjisë bujqësore nga fermerët e mëdhenj. Gjithashtu disa fermerëve të vegjël iu mungon njohuria adekuate mbi teknologjinë.

**Table 19: Përdorimi i plehrave minerale dhe organike sipas kulturave**

Kulturat	Sipërfaqja (ha)	Plehu Mineral		Plehu Organik	
		Përdorur (ton)	kg/ha	Përdorur (ton)	ton/ha
Drithërat	83.492	34.767	416,4	120.572	1,4
Perimet	11.738	7.458	635,3	59.816	5,1
Bimët foragjere	77.046	9.887	128,3	63.860	0,8
Pemët	3.889	544	140	11.632	3,0
Të tjera	102	12	117,6	195	1,9
Gjithsej	176.267	52.666		256.065	

<sup>18</sup> Te gjitha llojet tjera te pleherave mineral

Tabela 19. tregon përdorimin e plehrave minerale dhe organike sipas kulturave; kulturat janë paraqitur në grupe dhe është shënuar mesatarja e përdorimit të plehrave minerale dhe organike për hektar. Vlen të theksohet që sasi të janë të shprehura në bruto sasi. Kjo do të thotë që nuk ka informata të drejtpërdrejta sa i përket përdorimit neto të substancave aktive në plehra të ndryshëm mineral.

Perimet kanë sasinë më të madhe të plehut të përdorur për hektar, 635 kg/ha të plehrave mineral dhe 5.1 t/ha të plehut organik. Drithërat kanë 416 kg/ha të plehrave mineral dhe 1.4 t/ha të plehut organik. Shumica e plehrave janë përdorur për këto kultura, 47 % nga të dy llojet, plehrat mineral dhe organik.

Pas disa llogaritjeve të bëra doli që sasia prej 416 kg të plehrave mineral për hektar tek drithërat është në suaza normale. Rekomandimet teknike të përdorura në Kosovë janë se për drithëra duhet 50–150 kg Azot (N); 50–20 kg Fosfor ( $P_2O_5$ ) dhe 50–100 kg Kalium ( $K_2O$ ) si materie aktive. Përdorimi i plehut organik është relativisht i ultë por zvogëlimi i numrit të kafshëve pas lufte ka pasur ndikim negativ në prodhimin e plehut organik.

### **Mungesa e të dhënave**

Edhe për inputet bujqësore nevojitet një mostër më e madhe.

## 8 Fuqia punëtore në bujqësi

Të dhënat për fuqinë punëtore janë të rëndësishme për të vlerësuar se në çfarë mase bujqësia është në gjendje të absorbojë fuqinë punëtore rurale dhe shkallën e kërkimit të vendet e punës jo bujqësorë. Nga anketa e fundit mund të shihet se ka nevojë për politikën përtej bujqësisë, që synojnë zhvillimin rural. Për këtë arsye, anketa e ekonomive bujqësore 2004 mblodhi informata rreth punësimit në fermë të anëtarëve të ekonomive shtëpiake varësisht nga vendosmëria e tyre që të angazhohen në bujqësi, me orar të plotë, orar të shkurtuar, apo sezonal (Tabela 20.). Personat që kanë punuar së paku 20 orë në javë në bujqësi, janë klasifikuar si punëtorë më orar të shkurtuar. Personat që kanë punuar më pak se 20 orë në javë në bujqësi janë konsideruar si punëtor sezonal. Është bërë mbledhja e informatave edhe sa i përket numrit të ditëve të punës lidhur me fuqinë punëtore të angazhuar nga jashtë ferma.

Ditët e punës janë shndërruar në Njësi Vjetore Punuese (NVP) duke përdorur standardet nga shtetet anëtare të BE-së. Një NVP është vlerësuar të jetë e barabartë me 1,800 orë pune. Kohëzgjatja e ditës së punës është përcaktuar në 8 orë që rezulton me 225 ditë pune për vit, për një të punësuar me orar të plotë. Në interpretimin e anketës bujqësore të vitit 2001, ditët e punës për vit dhe personat janë vlerësuar në 250 pa ndonjë referim të orëve të punës dhe NVP.

Tabela 20. paraqet numrin e anëtarëve të ekonomive shtëpiake të angazhuar në fermë sipas gjinisë dhe shkallës së angazhimit në ekonominë bujqësore (me orar të plotë, orar të shkurtuar, apo marrje e punëtorëve sezonal).

**Table 20: Anëtarët e ekonomive shtëpiake të angazhuar në fermë**

Orar të plotë						
Moshë	Meshkuj		Femra		Gjithsej	
	Numër	%	Numër	%	Numër	%
<16	1.096	76	350	24	1.446	100
16-65	53.184	76	16.653	24	69.837	100
>65	1.044	74	363	26	1.407	100
Gjithsej	55.324	76	17.366	24	72.690	100
Orar të shkurtuar						
Moshë	Meshkuj		Femra		Gjithsej	
	Numër	%	Numër	%	Numër	%
<16	2.351	57	1.751	43	4.102	100
16-65	65.292	62	39.476	38	104.769	100
>65	998	56	794	44	1.791	100
Gjithsej	68.641	62	42.021	38	110.662	100
Sezonal						
Moshë	Meshkuj		Femra		Gjithsej	
	Numër	%	Numër	%	Numër	%
<16	5.526	53	4.880	47	10.406	100
16-65	63.950	53	57.606	47	121.556	100
>65	988	44	1.271	56	2.259	100
Gjithsej	70.464	52	63.757	48	134.221	100

Gjithsej 318.000 anëtarë të ekonomive shtëpiake të moshës aktive për punë kanë një shkallë angazhimi në aktivitetet bujqësore të fermës. Kjo paraqet rreth 50 % të të gjithë anëtarëve të ekonomive shtëpiake bujqësore të moshës mbi 14 vjeçare. Është e qartë se vetëm sektori i bujqësisë nuk mund të sigurojë punësim të popullsisë bujqësore andaj edhe sektorët tjerë të ekonomisë duhet të jenë së paku një punëdhënës i rëndësishëm në rajonet rurale sikurse bujqësia.

Tabela tregon se për të gjitha grup moshat pjesëmarrja e anëtarëve meshkuj të ekonomive shtëpiake me orar të plotë në punë të fermës është shumë më e lartë se sa e femrave (rreth 75 % e anëtarëve të ekonomive bujqësore të angazhuar janë meshkuj). Në krahasim me anketën e vitit 2001 përqindja meshkuj-femra të angazhuar me orar të plotë në bujqësi ka ndryshuar drejt një pjesëmarrje relativisht më të lartë të anëtarëve meshkuj të ekonomive shtëpiake. Ekzistojnë edhe dallime në gjini midis njerëzve që punojnë me orar të shkurtuar, për ata shënojnë një rënie në grupin e punëtorëve sezonale të angazhuar në bujqësi, p.sh. 53 % meshkuj, e 47 % femra.

Pjesa dërmuese e anëtarëve të ekonomive shtëpiake të angazhuar në bujqësi, 93 %, i përkasin moshës aktive për punë, midis 16 dhe 65 vjeç. Pjesa e mbetur janë ose të rinj nën moshën 16 vjeçare, 5 %, ose persona të pensionuar të moshës mbi 65 vjeç. Të rinjtë zakonisht janë të angazhuar në punë sezonale bujqësore pasi që i përkasin moshës kur pjesa dërmuese e tyre të shumtën e kohës janë duke e vijuar mësimin.

Tabela 21 paraqet numrin e ditëve të punës të punëtorëve të angazhuar me mëditje në fermat e ekonomive shtëpiake. Po ashtu janë cekur edhe të dhënat sa i përket gjinisë dhe moshës.

**Table 21: Fuqia punëtore me meditje e angazhuar në bujqësi, ditët e punës**

Moshë	Meshkuj		Femra		Gjithsej	
	Numër	(%)	Numër	(%)	Numër	(%)
<16	494	91	48	9	542	100
16-65	236.341	94	16.276	6	252.616	100
>65	365	100	0	0	365	100
Gjithsej	237.199	94	16.324	6	253.523	100

Zbatimi i procedurës së shndërrimit është shpjeguar më lartë, ditët e punës në tabelë paraqesin 1.127 persona të angazhuar me orar të plotë të paguar me mëditje. Ky numër kaq i vogël i punëtorëve të angazhuar në bujqësi ka të bëjë me madhësinë e vogël të fermës së ekonomisë shtëpiake që nuk mund të absorbojnë fuqi punëtore shtesë ndajë anëtarëve të ekonomive shtëpiake. Për më tepër, numri mesatar i anëtarëve për ekonomi shtëpiake në Kosovë është i lartë, duke ofruar tepicën të fuqisë punëtore.

Pjesa dominuese e fuqisë punëtore të angazhuar me mëditje i përkasin gjinisë mashkullore të moshës aktive për punë. Më së shpeshti, mëditja sillet prej 10–15 Euro. Nuk janë vërejtur dallime në gjini sa i përket pagesës, por në grup moshën e personave të rinj nën 16 vjeç, meshkujt fitojnë më shumë, 13 Euro në ditë, derisa femrat paguhen vetëm 10 Euro.

### **Mungesa e të dhënave**

Në përgjithësi është vështirë të matet punësimi në bujqësi në mënyrë të saktë. Shpesh vjen deri tek nën vlerësimi. Të shumtën e rasteve fermerët nuk llogarisin anëtarët e familjes si inpute të fuqisë punëtore në fermë.

## 9 Shpenzimet e fermës

Gjatë anketës së ekonomive shtëpiake bujqësore 2004, janë mbledhur të dhënat për shpenzimet dhe të ardhurat, në një përpjekje për të plotësuar mungesën e të dhënave ekzistuese sa i përket statistikave ekonomive në nivel të fermës dhe ekonomisë shtëpiake. Gradualisht këto informata do të plotësohen me të dhëna të mbledhura nga Rrjeti i të Dhënave për Kontabilitetin e Fermave (FADN), në përputhje me definicionet e BE-së. Të dhënat për shpenzimet në fermë sipas artikujve madhorë tek fermat e mëdha dhe të vogla, dhe të ardhurave të fermës janë çështje e ndjeshme për mënyrën e vlerësimit që fermerët i bëjnë punës së tyre dhe punës së anëtarëve të ekonomisë shtëpiake në fermë. Shpeshherë kjo vlerë është deklaruar më e vogël, gjë që ka rezultuar me nënvlerësimin e shpenzimeve për pagat mujore dhe mëditjet.

Shpenzimet mesatare për fermë janë 658 Euro, që është më shumë se fitimi i raportuar prej 507 Euro. Fermat e vogla raportojnë shpenzime në vlerë prej 578 Euro dhe fitim prej 408 Euro. Një arsye përse shpenzimet janë më të larta se sa të ardhurat është se shumica e fermave të vogla prodhojnë produkte për ekonominë shtëpiake, që nuk shiten. Sidoqoftë, shumë ekonomi shtëpiake kanë burime tjera të të ardhurave për të paguar shpenzimet e aktiviteteve në bujqësisë. Fermat e mëdha dhe të specializuara kanë qarkullim më të madh të ardhurave që do të thotë se mesatarja e tyre është rreth 31.522 Euro, kurse shpenzimet janë rreth 25.813 Euro, andaj ky grup mund të mbulojë shpenzimet e fermës me të ardhurat e krijuara.

Tabela 22. tregon strukturën e shpenzimeve në prodhimtarinë e fermës sipas shpenzimeve kryesore për ferma të vogla, ferma të mëdha dhe në përgjithësi.

**Table 22: Struktura e shpenzimeve në fermë**

Kategoria e shpenzimit	Fermat e vogla		Fermat e mëdha		Gjithsej	
	Gjithsej shpenzime		Gjithsej shpenzime		Gjithsej shpenzime	
	Euro	%	Euro	%	Euro	%
Plehra mineral	12.079.815	17,8	662.466	6,8	12.742.281	16,4
Plehra organik	1.219.748	1,8	25.134	0,3	1.244.882	1,6
Kemikalet	1.626.513	2,4	244.179	2,5	1.870.692	2,4
Farërat	7.231.392	10,6	683.159	7,0	7.914.551	10,2
Ushqimi i kafshëve	6.116.400	9,0	2.437.205	25,1	8.553.605	11,0
Blerjet e kafshëve	6.586.719	9,7	1.669.084	17,2	8.255.803	10,6
Shërbimet veterinarë	1.838.410	2,7	157.726	1,6	1.996.136	2,6
Pagat dhe rrogat	2.545.088	3,7	1.151.212	11,9	3.696.300	4,8
Lënda djegëse	8.735.505	12,9	732.310	7,5	9.467.815	12,2
Riparimet dhe mirëmbajtjet	3.959.697	5,8	259.791	2,7	4.219.488	5,4
Shërbimet e kontraktuara dhe qiraja për shfrytëzimin e makinerisë	9.365.077	13,8	212.911	2,2	9.577.988	12,3
Mirëmbajtja dhe riparimi i fermës	1.075.763	1,6	281.581	2,9	1.357.344	1,7
Qiraja e paguar për shfrytëzimin e tokës dhe ndërtesave	693.512	1,0	482.085	5,0	1.175.597	1,5
Rryma elektrike, telefoni etj.	3.135.563	4,6	136.750	1,4	3.272.313	4,2
Kamata nga kreditë	265.729	0,4	283.512	2,9	549.241	0,7
Shpenzimet tjera operative	1.466.970	2,2	286.453	3,0	1.753.423	2,3
Gjithsej	67.941.900	100,0	9.705.558	100,0	77.647.458	100,0

Kategoritë kryesore të shpenzimeve janë plehrat minerale, shërbimet e kontraktuara dhe qiraja e paguar për makineri, karburante, farëra, ushqim dhe blerje të kafshëve. Këto shpenzime përbëjnë rreth 75 % të shpenzimeve të të gjitha fermave. Shuma e vogël e shpenzimeve në mirëmbajtje të ndërtesave të fermës është për shkak të faktit se shpesh herë e vetmja gjë që posedojnë fermat e vogla është një ngastër toke. Shpenzimet tjera me pjesëmarrje të vogël në shpenzimet e fermës janë kamata në kredi.

Në Kosovë kreditë nga bankat nuk shfrytëzohen në masë të madhe për bujqësi. Fermerët huazojnë para nga shokët dhe familja pa ndonjë marrëveshje formale as i përket pagesës së kamatës. Disa bile tentojnë që të mos i numërojnë këto si kredi.

Ekzistojnë shumë dallime në strukturën e shpenzimeve midis fermave të vogla dhe të mëdha. Fermat e voglat përdorin rreth 55 % të shpenzimeve të përgjithshme në kultivimin e kulturave, kryesisht farëra, plehra, karburante, shërbime të kontraktuar dhe marrjen e makinave me qira. Rreth 70 % të fermave të mëdha janë orientuara në blegtori, kjo ka ndikuar në koston e tyre ku rreth 42 % shpenzohen për ushqim dhe blerje të kafshëve.

Fermat e mëdha kanë angazhuar fuqi punëtore dhe kanë paguar 12 % të shpenzimeve të përgjithshme për paga dhe mëditje. Ato po ashtu shpenzojnë më shumë sa i përket qirasë për shfrytëzimin e tokës dhe ndërtesave dhe interesit në kredi. Tabela 23. paraqet llogaritjen e shpenzimeve të përgjithshme në prodhimtarinë e fermave sipas komunave.

**Table 23: Llojet e shpenzimeve të fermës sipas komunave**

Komuna	Plehrat dhe kemikaliet	Farërat	Blegtoria	Makineria	Pagat dhe mëditjet	Shpenzimet tjera	Gjithsej
Kosova	15.857.854	7.914.551	18.805.544	23.265.291	3.696.300	6.354.494	77.647.458
Deçani	236.323	142.673	585.086	467.187	147.983	31.610	1.579.251
Gjakova	710.487	281.061	2.156.544	1.231.645	232.664	390.221	4.612.401
Gllgoci	785.206	545.292	112.591	866.563	104.953	63.422	2.414.605
Gjilani	541.337	185.811	995.456	675.253	306.184	81.715	2.704.041
Dragashi	89.956	9.228	408.845	157.029	11.772	40.609	676.830
Istogu	621.609	320.698	695.655	915.739	268.802	438.916	2.822.503
Kaçaniku	128.215	77.973	461.084	296.125	36.956	36.273	1.000.354
Klina	830.412	845.302	480.462	1.009.037	311.603	209.984	3.476.816
Fushë Kosova	353.324	137.889	330.088	677.171	36.061	80.802	1.534.533
Kamenica	463.036	105.722	273.990	516.899	59.766	65.601	1.419.413
Mitrovica	61.457	58.886	320.603	302.381	63.287	26.139	806.613
Leposaviqi	395.210	175.694	476.443	599.886	23.014	348.532	1.670.247
Lipjani	1.219.107	508.726	1.733.146	2.315.854	332.736	1.628.809	6.109.568
Novo Brda	67.481	23.453	42.259	84.739	0	19.028	217.931
Obiliqi	261.408	88.435	241.817	417.407	31.364	63.284	1.040.431
Rahoveci	1.921.764	756.717	793.055	2.194.049	281.237	1.510.749	5.946.822
Peja	574.439	389.379	747.389	932.503	273.906	185.462	2.917.617
Podujeva	660.315	364.463	800.013	1.114.624	133.840	161.187	3.073.255
Prishtina	530.733	219.999	251.994	1.046.021	97.514	145.920	2.146.262
Prizreni	366.327	152.576	1.048.235	687.499	100.491	45.374	2.355.128
Skenderaj	634.632	347.802	544.416	656.416	27.364	201.800	2.210.629
Shtimja	244.881	132.223	242.805	338.791	15.535	11.710	974.235
Shterpeca	508.359	58.332	167.731	293.027	5.715	25.625	1.033.164
Suha Reka	532.395	310.710	929.562	1.105.137	115.531	36.780	2.993.336
Ferizaji	605.325	294.062	374.701	684.516	183.673	89.903	2.142.277
Vitia	844.723	348.599	473.805	860.610	77.346	24.729	2.605.083
Vushtrria	840.313	619.105	576.285	1.281.446	217.823	237.192	3.534.972
Zubin Potoku	60.349	19.857	244.853	79.084	109.459	18.336	513.602
Zveçani	188.874	55.075	1.589.524	306.725	13.970	121.358	2.154.168
Malisheva	579.857	338.810	707.108	1.151.928	75.753	13.428	2.853.455
Përqind (%)	20	10	24	30	5	8	100

Për të lehtësuar përdorimin e tabelës, kategoritë e kostos janë grupuar në krahasim me tabelën 22. Plehrat minerale, organike dhe kemikalet janë vendosur bashkërisht në një grup të veçantë "Plehrat dhe kemikalet"; ushqimi i kafshëve, blerja e kafshëve dhe shërbimet veterinarë janë nën grupin "Blegtoria"; rregullimi i makinerisë dhe mirëmbajtja, shërbimet e kontraktuara dhe qiraja e shfrytëzimit të makinave dhe karburantet janë nën grupin "Makineria". Të gjitha shpenzimet e mbetura të vogla janë grupuar nën "Shpenzimet tjera".



## **Enti Statistikës së Kosovës (ESK) – përshkrim i shkurtër**

**Enti i Statistikës** si Ent profesional vepron që nga viti 1948, dhe ka kaluar nëpër të gjitha fazat historike të Kosovës. Me 2 Gusht të vitit 1999 Enti ka rifilluar punën e tij si i pavarur dhe si Institut profesional i administratës publike profesionale. Buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe donatorët e ndryshëm për projekte të veçanta e financojnë Entin.

**Rregullorja për Statistika** (Rregullorja 2001/14) ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. ESK është një agjencion ekzekutiv i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike (MSHP). Një Master Plan (plan zhvillimor afatmesëm) për sistemin statistikor është në zhvillim e sipër.

**Struktura organizative:** Shtatë Zyra Rajonale (Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Mitrovicë, dhe Qendra Kryesore në Prishtinë) për momentin kanë gjithsej 137 të punësuar, 90 të punësuar në QK dhe 47 të punësuar në Zyrat Rajonale. Është 1 ekspertë internacional prezent në përkrahje Entit si dhe 1 asistent gjuhësor. Enti i Statistikës së Kosovës ka një teren krejtësisht të mbuluar për organizimin e anketave me regjistruar me përvojë dhe mundësi të mjaftueshme të transportit. Një organizim i ri i Entit është implementuar kohëve të fundit. Grupi punuese mbi Statistikat përfshirë këtu shumicën e Ministrive, është në krijim.

**Misioni i Entit** është që t'i përmbushë nevojat e përdoruesve për të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare dhe t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit dhe përdoruesit tjerë në Kosovë..

- **Adresa:** Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë
- **Telefonat:**  
Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111  
Drejtori: +381 (0) 38 235 545 ose +381 (0) 38 504 604 lok. 6572
- **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [agriculture@ks-gov.net](mailto:agriculture@ks-gov.net)
- **Web-faqe:** [www.ks-gov.net/esk](http://www.ks-gov.net/esk)